**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"DANILO INVEST" sh.p.k**

Në Tiranë, sot me datë **26.04.2024**, ne, ortaku themelues:
**Danilo Haka,** i biri i Vullnet-it dhe i Nadire, lindur në Tiranë më 14.05.1997, banues në Tiranë, Tiranë, deklaroj se me vullnetin tim të lirë e të plotë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në *Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe • Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit"; • Ligjin nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; • Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"; • Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"; • Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", si dhe në legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor* vendosa të themelojë Shoqërinë me Përgjegjësi te Kufizuar te emëruar **"DANILO INVEST" sh.p.k** (*me poshtë referuar si "Shoqëria"*), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjese përbërëse e këtij Akti Themelimi

**Neni 1**
**FORMIMI i SHOQERISE**

**Formohet shoqëria e me pergjegjesi te kufizuar, me emrin: "DANILO INVEST" sh.p.k** Themelohet Shoqëria **"DANILO INVEST" sh.p.k**, person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").
Emertimi tregtar i shoqërisë është: **"DANILO INVEST" sh.p.k**

**Neni 2**
**Selia e Shoqërisë**

Selia zyrtare e Shoqërise ndodhet në adresën: ***Ambjent Shërbimi* Kati 4rt, Pajtoni Business Center, Pasuria 164/63-N10, Rruga Dytësore Tiranë Durrës km1, Tiranë.**

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqerise mund te transferohet ne nje rajon tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Gjithashtu, shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo dhe jashte tij.

**Neni 3**
**Kohëzgjatja e Veprimtarisë Ekonomike**

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrit.

**Neni 4**
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË**

***Objekti i veprimtarise se shoqërisë është:***

1. **Operator turistik; Operator i turizmit detar që zhvillon aktivitete rekreative turistike detare për gjate vijës bregdetare, hapsirës detare dhe në ujrat e brendshme të Republikës së Shqipërisë të tilla si: lundrimi për qëllime turistike dhe argëtim, surf-I, zhytje çlodhese, windsurf-I ski në ujë, wakeboard-I, motor uji, peshkim turistik etj;**
2. ***Shitblerja edhe dhënia me qera e pasurive të paluajtshme.*** *Veprimtari*

*që lidhen me blerjen e shitjen edhe dhënie me qera të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si dhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, dege ndërmarrjesh, si edhe te këtë interesa ose pjesëmarrje ne shoqëri e ne koncesione, te themeluara apo ne themelim e sipër, qe kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me objektin e vet, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë*

3. Import eksport edhe shitblerja e mjeteve motorike të ujit dhe transport detar të njërzve të mallrave për vete dhe për të tretët.
4. *Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare që lidhen drejt për drejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë se shoqërisë, brenda kuadrit te dispozitave ligjore për realizimin e çdo biznesi të përshtatshëm në arritjen e qëllimit të shoqërisë;*
5. Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hapë njësi tregëtimi, shërbimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizike e juridike vendas dhe të huaj.
6. *Shoqeria mund të ushtrojë çdo veprimatri tjeter tregetare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare").*

**Neni 5**

**Kapitali i Shoqërisë**

1. Kapitali i shoqërisë është **100.000,00 Lekë** dhe është i ndarë në 1 (kuotë) dhe zotërohet tërësisht nga ortaku themnelues Danilo Haka.
2. Fondet që do të derdhen, lista e ortakeve me te dhenat e tyre personale dhe vlera e kontributeve përkatëse të ortakut do të depozitohen ne Bankë për llogari te shoqërise ne formim e sipër.
3. Fondet e derdhura, lista e ortakeve me te dhenat e tyre personale dhe vlera e kontributeve perkatese te ortakeve janë evidentuar në aktet e shoqërisë edhe gjendet të pasyruara në regjistrat që administrojnë regjistrin tregtar të subjekteve tregtare.
4. Kapitali i shoqërisë është **100.000,00 Lekë** është nënshkruar plotesisht, është e ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet nga ortakët e shoqërisë si vijon:**Ortaku, Danilo Haka**: zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **100.000,00,** e cila përbën **100 %** të kapitalit të shoqërisë;
5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë(pasuri të luajtshme/të paluajtëshme apo të drejta).

**Neni 6**

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj janë si me poshtë:

1. Asambleja e Ortakut të Vetëm/Ortakëve
2. Administratori.

**<u>Administrator i shoqërisë është;</u>**

**Danilo Haka,** i biri i Vullnet-it dhe i Nadire, lindur në Tiranë më 14.05.1997, banues në Tiranë, Tiranë, i identifikuar me karten e identitetit me numer personal J70514055P, leshuar me 19.04.2021.

Kompetencat e Asamblesë e Asamblesë së Oratkut të Vetëm/Ortakëve të vetëm dhe te Administratorit janë te përcaktuara ne Statutin e shoqërisë.

**Neni 7**

Ortaket dhe punonjësit e shoqërisë janë te detyruar qe te ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe te informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda

kontekstit te shoqërisë dhe te evitojnë përhapjen e tyre qofte dhe pjesërisht.

**Neni 8**

**Marrëdhëniet e Punës**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria private merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit janë te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen për demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 9**

**Konfidencialiteti, Ruajtja e Sekretit**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

**Neni 10**

Ne se shoqëria do te likuidohet atëherë do te caktohet një komision likuidimi qe do te parashtroje një bilanc likuidimi për miratim.

**Neni 11**

**Ekspertet ose Revizoret Kontabël**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet nje eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndrojë ne detyre per aq sa përcaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakut te vetëm cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

**Neni 12**

**BILANCI DHE FITIMET**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

**Neni 13**

Çdo mosmarrëveshje qe lind ndërmjet ortakëve ne lidhje me ketë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo qe nuk kane te bëjnë me Shoqërinë), do te zgjidhet me mirëkuptim dhe do te diskutohet ne mënyre te drejtpërdrejtë ndërmjet palëve te interesuara.
Ne rast se nuk arrihet ne një zgjidhje me mirëkuptim te mosmarrëveshjes, çështja do t'i kaloje për gjykim Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane.

**Neni 14**

Ky akt themelimi, si konfirmim i vullnetit te ortakëve themelues, nënshkruhet rregullisht prej tyre ne Tiranë, sot më 27.12.2023

**ORTAKU I VETËM THEMELUES "DANILO INVEST" sh.p.k**

**Danilo Haka** ______________________